

TESTAMENTI - VASIJETI

Dr. Musli Vërbani



Dr. Musli Vërbani

TESTAMENTI (VASIJETI)

الوصية

Kaçanik, 2011

Autor:
Dr. Musli VËRBANI

Titulli:
TESTAMENTI (VASIJETI)

Korrektura:
Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

Botues: **Autori**

Shtypi:
“FokusPrint”, 2011

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Hyrja

Lexues të dashur, ky libër është libër që përmban shumë pak fjalë, por që është shumë i rëndësishëm për jetën tënde në botën tjetër. Me këtë punim modest jam munduar vetëm të vë në pah dhe të sqaroj këtë temë, që prej saj të përfitohet dhe të zbatohet. Në kohën e sodit, në viset tona, shumë pak dinë për testamentin, e shumë më pak, apo, për të mos thënë, fare nuk e zbatojnë atë. Këtë e konstatojmë nga shkaku se nuk dëgjojmë dhe nuk lexojmë se dikush ka lënë diçka testament, ndërsa në të kaluarën ky institucion ka qenë prezent dhe është praktikuar.

Testamenti është i vjetër aq sa trashëgimia, edhe pse ka zëra se trashëgimia testamentare është paraqitur më vonë. Testamenti ekzistonte edhe te grekët edhe te romakët. Në disa epoka testamentin e shfrytëzonin për qëllime të këqija dhe për padrejtësi. Te romakët kryefamiljari kishte të drejtë që, nëpërmjet testmanetit, me pasurinë e tij të vepronte si të donte, t'i linte testament njeriut të huaj dhe t'ua ndalonte të drejtën e trashëgimisë fëmijëve të tij. Pastaj, më vonë, u ishte dhënë e drejta që fëmijët të trashëgonin një të katërtën e pasurisë, me kusht që fëmijët të ishin sjellë tepër mirë me prindërit e tyre.

Tek arabët, në kohën e injorancës, vetëm për krekosje u linin testament të huajve, e të afërmit e vet i lënin të varfër. Mirëpo, më vonë, Islami përmirësoi dhe rregulloi destinimin e Vasijetit (testamentit) në mënyrë të drejtë. Në rend të parë ai detyroi që tërë pasuria t'u lihet Vasijet (testament) prindërve dhe të afërmeve. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (Vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejt. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer.”
(El-Bekare, 180)

Pastaj, në suretu En-Nisa, në mënyrë të detajuar, përcaktohet e drejta e trashëgimisë dhe Vasijeti ligjësohet, por duke paraparë dy kushte esenciale:

1. Që Vasijeti (testamenti) të mos jetë më i madhe se 1/3 e pasurisë, sepse Muhamedi s.a.v.s. i thotë Sead bin Vekasit: *“Lëre Vasijet 1/3, sepse edhe 1/3 është shumë. Më mirë t’i lësh trashëgimtarët të pasur se sa t’i lësh të varfër, duke u kërkuar njerëzve lëmoshë.”*
2. Që Vasijeti (testamenti) të mos u lihet trashëgimtarëve, ngase kjo është e ndaluar, sepse trashëgimtarët gëzojnë të drejtën e trashëgimisë (e jo të Vasijetit). Mirëpo, edhe Vasijetin mund ta gëzojë ndonjë trashëgimtar, nëse këtë ia lejojnë trashëgimtarët e tjerë.

Edhe Vakëfi mund të lihet nëpërmjet testamentit, dhe kjo në atë mënyrë që të lihet testament vlara e një të tretës së pasurisë së paluajtshme, që pas vdekjes e merr emërtimin e vakëfit.

Të gjithë muslimanët falen në drejtim të Qabesë, ndërsa themelet e Qabesë i ka ngritur Ibrahim i a.s., që e ka lënë vakëf.

Edhe Omeri r.a. ka lënë vakëf parcelën e tij të Hajberit. Omeri r.a. e kishte pyetur Muhamedin a.s. se si të vepronte me pasurinë e tij, që të kishte shpërblim të vazhdueshëm tek Allahu. Muhamedi a.s. i propozoi që ta linte vakëf parcelën e tij.

Kështu Omeri r.a. urdhëroi që vakëfi i tij të mos shitej, as të trashëgohej dhe as të dhurohej.

Ky veprim i Omerit r.a. që bërë shembull për ashabët që edhe ata të ndiqnin rrugën e tij. Kështu që, thuhet se, nuk pati asnjë nga sahabët e pasur që të mos kishte lënë vakëf.

Muhamedi a.s. jo vetëm i kishte nxitur të tjerët që të linin vakëf, por edhe vetë ai i la vakëf shtatë bahçet e tij në Medinë.

Lusim Zotin e Lartmadhëruar që të na bëjë nga ata që e pasojnë rrugën e Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s., të Ibrahimit a.s. dhe sahabëve, që edhe ne të lëmë vasijet, që nëpërmjet vasijetit të shtohen vakëfet, e në botën tjetër të jemi në shoqëri me ta.

Testamenti (vasijeti)

الوصية – *Vasijet* gjuhësisht do të thotë *këshillë dhe porosi për të vepruar ose për të mos vepruar diçka*. Mirëpo në sheriatin islam, dijetarët i japin përcaktimin tjetër, që përputhet me dispozitat e legjislacionit islam. Sipas tyre, *Vasijet* është: *Veprim që bëhet detyrim për testamentpranuesin nga testamentlënësi, i cili lë pas vetes një të drejtë të tij*.¹

Testamenti dallon nga dhurata për faktin se testamentpranuesi e fiton të drejtën (e posedimit dhe shfrytëzimit) të atij testamenti vetëm pas vdekjes së testamentlënësit, kurse dhuratën mund ta shfrytëzojë personi të cilit i dhurohet diçka, që në momentin e dhurimit; gjithashtu testamenti, për dallim nga dhurata, është i vlefshëm deri në një të tretën e pasurisë së testamentlënësit; testamenti mund të jetë në sende të prekshme – konkrete dhe gjëra jo të prekshme, të cilat mund të shfrytëzohen, kurse dhurata vlen vetëm për çështje konkrete dhe të prekshme.

Ka edhe një përkufizim tjetër për testamentin:

“Të kërkuarit e një njeriu nga një njeri tjetër që të veprojë diçka në mungesë të tij, pas vdekjes së tij.”

Kjo tregon se fukahenjtë kishin dhënë përkufizime të ndryshme për testamentin.

Argumentet e ligjësimilit të testamentit

1. Argumenti nga Kur'ani

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كُتِبَ عَلَيْكُمُ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ إِن تَرَكَ خَيْرًا
الْوَصِيَّةَ لِلْوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِينَ بِالْمَعْرُوفِ حَقًّا عَلَى الْمُتَّقِينَ

“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (Vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejt. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer.”

(El-Bekare, 180)

Kështu ishte në fillim të Islamit (lënia testament për prindër dhe të afërm), pastaj ky ajet është shfuqizuar me ajetet e trashëgimisë në suretun Nisa, kurse për sa i përket ajetit të lartpërmendur, ka mbetur aktiv lidhur me lënien e Vasijetit për të tjerët, përveç trashëgimtarëve. Transmetohet nga Omeri r.a. se e kishte dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s., duke thënë: *“Vërtet Allahu ia ka dhënë secilit të drejtën e tij në trashëgimi, për këtë arsye nuk lejohet të lihet testament për trashëgimtarin.”*

Po ashtu në ajetin tjetër kur'anor, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

... مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْ دَيْنٍ ...

“(Kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet testamenti (Vasijeti) që ka lënë dhe pasi të lahet borxhi...”

(En-Nisa, 11).

2. Argumenti i Sunetit

Sead bin Vekasi shkon te Pejgamberi s.a.v.s., dhe i kërkoj që dy të tretat e pasurisë së tij të shpërndante (ta linte Vasijet), kurse një të tretën t’ia linte vetëm një vajze e cila e trashëgonte. Muhamedi a.s. këtë nuk ia lejoi. Pastaj ai i kërkoj që ta shpërndante (ta linte Vasijet) një të dytën, e Pejgamberi s.a.v.s. edhe këtë i refuzoi. E pastaj Muhamedi s.a.v.s., i thotë: *“Një të tretën (mund ta lësh Vasijet), për shkak se është më mirë që pasardhësit t’i lësh me pasuri se sa të varfër e lypsa.”*

3. Argumenti i Ixhamit

Të gjithë dijetarët e Umetit janë deklaruar se testamenti (Vasijeti) është i lejuar.

4. Argumenti logjik

Testamenti është prej veprave të mira dhe shton devotshmërinë ndaj Allahut.

Urtësia e testamentit

Testamenti ka rëndësi të veçantë fetare, morale dhe juridike.

Sikurse çdo vepër e mirë, ashtu ka vlerë edhe testamenti, sepse prej tij arrihet dobia dhe e mira në këtë botë dhe shpërblimi në botën tjetër. Përmes testamentit, ndihmohen institucionet islame, institucionet bamirëse, plotësohen nevojat e nevojtarëve, mënjahen vështirësitë e të dobëtëve. Për këtë arsye ligjësimi i testamentit është në interes të përgjithshëm të shoqërisë.

Testamenti ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin ekonomik, në raportet e njerëzve në mes tyre në këtë botë, po ashtu edhe që të arrihet shpërblimi në Botën tjetër.

Nëpërmjet testamentit, njeriu realizon punë të mira, të cilat nuk ka pasur rast t'i kryejë më herët.

Ruknet e testamentit

Të gjithë dijetarët janë të pajtimit se rukni i vetëm i testamentit është oferta dhe pranimi i ofertës.

Praktikisht oferta bëhet në këtë mënyrë:

“I kam lënë X pasuri (e shënon pasurinë) X personit (e shënon emrin e personit).” Ose shprehet: ***“Një të tretën e pasurisë sime, pas vdekjes sime, i lë testament filanit.”***

Kusht i pranimit të ofertës është vdekja e testamentlënësit (sepse testamenti ndryshon nga dhurata). Nëse testamentpranuesi e pranon (e merr në shfrytëzim) pasurinë-testamentin para se të vdesë testamentlënësi, veprimi i tillë është i pavlefshëm, me fjalë të tjera, pasuria i kthehet testamentlënësit, dhe ai (testamentpranuesi) duhet ta pranojë testamentin (pasurinë), vetëm pasi të vdesë testamentlënësi.

Oferta e testamentit bëhet me një prej këtyre tri formave:

1. Me shkrim;
2. Nëpërmes deklaratës, d.m.th. me të shprehur;
3. Me shenja, në pamundësi të të shprehurit apo të të shkruarit. Njeriu që mund të flasë, nëse dëshiron, testamentin e shpreh duke e deklaruar me gojë, por, nëse dëshiron, e bën me shkrim. Për sa i përket memecit, ai, nëse di të shkruajë, nuk i vlen (lënia e testamentit) me shenja, por, nëse nuk di të shkruajë dhe nuk mund të flasë, atëherë testamentin e lë me shenja ose me simbole.

Kushtet e testamentit

Kushtet e testamentit ndahen në:

1. Kushtet e testamentlënësit.
2. Kushtet e sendit të lënë testament, dhe
3. Kushtet e testamentpranuesit (legatorit).

- Kushtet e testamentlënësit

Kushtet që duhet t'i plotësojë testamentlënësi, janë:

1. **Të jetë i moshës madhore.** Nuk është i vlefshëm testamenti i fëmijës.
2. **Të jetë i mençur.** Gjithashtu nuk pranohet testamenti i të dehurit, sepse rasti i tillë është i ngjashëm me të çmendurin dhe se i dehuri nuk mund ta kontrollojë atë që flet.
3. **Të jetë pronar i sendit të lënë testament.** Pronar i një pasurie është çdo njeri që është kompetent për të vepruar me atë pasuri, për ta shitur ose për ta dhuruar. Ky posedon të drejtën që atë send ta lërë testament, por gjithnjë duke pasur parasysh një të tretën e pronësisë së tij.
4. **Të mos jetë i detyruar.** Testamenti është e drejtë e vullnetit të lirë, prandaj i detyruari nuk e ka këtë të drejtë. Për këtë arsye, testamenti i të detyruarit është i pavlefshëm.
5. **Të mos ketë borxh, i cili përfshin tërë pasurinë e tij.** Borxhi ka përparësi ndaj testamentit dhe pasuria e borxhliut është e varur prej borxhit, që është e drejtë e atij të cilit i ka borxh. Nëse njeriu të cilit i ka borxh (borxhdhënësi) heq dorë nga ajo e drejtë (ia falë borxhin) dhe këtë ia lejon (borxhmarrësit i cili e lë testamentin), atëherë testamenti i tillë lejohet dhe zbatohet, në të kundërtën ai testament është i pavlefshëm.

- Kushtet e sendit të lënë testament

Kushtet e sendit të lënë testament janë:

1. Që të jetë prej sendeve të ngjashme që trashëgohen apo kontrahohen;
2. Që sendi të jetë në pronësi të testamentlënësit;
3. Që ai send apo ajo vlerë të jetë sa një e treta e pasurisë së testamentlënësit ose edhe më pak. Nëse trashëgimtarët e pranojnë atë që i vdekuri ka lënë testament më shumë se një të tretën e pasurisë së tij, atëherë bëhet e vlefshme edhe më shumë se një e treta;
4. Që të mos jetë për bërje mëkatesh.

Testament mund të lihet pasuria e tundshme edhe ajo e patundshme. Prandaj, testament mund të jetë pasuria që shitet dhe blihet, dhe që shfrytëzohet. Lëndë e testamentit mund të jetë një plantacion, por mund të jenë edhe frutat e një plantacioni. Testament mund të lihet një shtëpi, një parcelë e të ngjashme.

- Kushtet e testamentpranuesit (legatorit)

Kushtet e testamentpranuesit janë:

1. Që të jetë i identifikuar (të dihet personi se kush është ai);
2. Që të jetë i pranishëm ose i gjallë.
Nëse testamentpranuesi ka vdekur para se t'i lihet testamenti, atëherë testamenti i tillë është i pavlefshëm;
3. Që të mos e përdor për bërje mëkatesh;
4. Që të mos jetë sulmues ndaj Islamit;
5. Që testamentpranuesi (legatori) të mos jetë vrasës i testamentlënësit;
6. Që të mos jetë trashëgimtar i testamentlënësit.
Muhamedi s.a.v.s., ka thënë: *“Vërtet Allahu ia ka dhënë të drejtën secilit (në trashëgimi), për këtë arsye nuk ka testament për trashëgimtarin.”* (Transmetojnë pesë koleksionistët, përpveç Nesaiut).

Llojet e testamentit

Testamenti mund të jetë: vaxhib, haram, mekruh dhe mustehab.

1. Testamenti vaxhib (i obliguar)

Është testamenti që e lë personi për t'u realizuar e drejta e një personi që e meriton atë të drejtë. Si, fjala vjen, testamenti për larjen e borxhit personave të panjohur, sepse, nëse vdes (testamentlënësi), atëherë ata persona nuk mund ta realizojnë atë të drejtë, sepse kështu ka frikë se ata mund të futen në mëkate.

Po ashtu vaxhib është testamenti ndaj drejtave ndaj Allahut. P.sh.:

- Kur njeriu nuk i ka kryer obligimet materiale ndaj Zotit të Lartmadhëruar. Si p.sh. nëse nuk e ka kryer obligimin e zekatit. Në këtë rast ai e ka për obligim të lërë testament që prej pasurisë së tij të jepet zekati (obligim të cilin nuk e ka kryer).
- Ose p.sh., nëse nuk e ka kryer ndonjë kefareti (kompensim për shkeljen e ndonjë detyrimi në Sheriatin islam). Ai e ka detyrim të lërë testament që të kryhet kefareti (kompensimi), si p.sh., nëse e ka prishur dhe ka ngrënë me qëllim një ditë të ramazanit. Ai në këtë rast e ka obligim t'i agjërojë 60 ditë pandërprerë, ose t'i ushqejë 60 të varfër. E nëse e ka kapluar pleqëria dhe është para vdekjes, ai e ka obligim të lërë testament, që, nëse vdes, t'i kryhet kefareti (kompensimi), me fjalë të tjera, t'i ushqejë 60 të varfër.

2. Testamenti haram (i ndaluar)

- *E ndaluar* – *haram është t'i lësh testament trashëgimtarit.* Si p.sh.: Nëse i lihet testament diçka djalit të madh apo fëmijëve të tjerë. Po ashtu është haram t'i lihet testament bashkëshortes (ngase edhe bashkëshortja është nga ato që trashëgojnë).
- *Nëse lihet testament më shumë se një e treta e pasurisë.* Duhet ditur se, nëse këtë e pranojnë trashëgimtarët, atëherë ai testament realizohet, e nëse nuk e pranojnë, kthehet në kufirin e një të tretës së pasurisë së testamentlënësit, ndërsa ajo që është më shumë se 1/3, nuk i kryhet.
- Nëse ndonjëri ka shumë fëmijë, ndërsa më të madhin dhe të dytin e ka martuar, kurse të tretin nuk e ka martuar, prandaj i lë *testament në shumën e shpenzimeve të një martese*, atëherë ai testament, për djalin më të vogël, është haram. Nëse ndonjëri ka bërë një gjë të tillë pa dije, çështja u lihet trashëgimtarëve, nëse ata e lejojnë, atëherë ai testament realizohet, e nëse jo, nuk realizohet.
- Haram është testamenti *nëse qëllimi i tij është që të dëmtohen trashëgimtarët.* Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“(Kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet testamenti (Vasijeti) që ka lënë dhe pasi të lahet borxhi...”**, (En-Nisa, 11) d.m.th. pa dëmtuar askënd.
- Testamenti haram është *testamenti që lihet për projekte me qëllim të realizimit të mëkateve të mëdha.*

3. Testamenti mekruh (i urryer)

Testamenti mekruh është testamenti i lënë për personat kriminelë apo mëkatarë të mëdhenj.

Nëse lihet testament me qëllim që të largohet ndonjë person nga mëkatet dhe të drejtohet në rrugë të drejtë e të pendohet, në një rast të tillë testamenti nuk është mekruh.

Testamenti nuk u lihet as personave që janë të njohur për shkapërderdhje të pasurisë dhe as personave amoralë.

4. Testamenti mubah (i lejuar)

Pjesa e pasurisë e cila lihet testament e që nuk e kalon një të tretën, është mubah.

Nëse një njeri ka shumë pasuri, mustehab është që të lërë testament diçka prej pasurisë, ngase do t'i vazhdojnë shpërblimet edhe pas vdekjes së tij. Kjo, për shkak se Muhamedi a.s. në hadith ka thënë: *“Nëse vdes i biri i Ademit, i ndërpriten të gjitha shpërblimet, përveç në tri raste, që janë: sadakaja rrjedhëse, fëmija i mirë që lutet për të, dhe dituria prej së cilës ka dobi.”*

Duhet ditur se testamenti mustehab (i pëlqyer) është ai që është më pak se një e treta e pasurisë. Kjo nga thënia e Ibni Abasit, i cili ka thënë: *“(Për çudi!) Njerëzit po e praktikojnë që të lënë testament një të katërtën e pasurisë, kurse Muhamedi s.a.v.s., i ka thënë Sead bin Vekasit: “Lëre testament një të tretën, edhe pse edhe një e treta e pasurisë është tepër.”*

Por, edhe lënia testament e një të pestës apo një të gjashtës, është e pëlqyeshme, e maksimumi i testamentit është një e treta.

Nëse testamentlënësi nuk ka fare trashëgimtarë, mund ta lërë testament tërë pasurinë, për shkak se trashëgimtarët janë pengesë për të lënë testament më shumë se një të tretën.

Është mustehab (e pëlqyer) që një pjesë e pasurisë të lihet testament, për shkak se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

كُتِبَ عَلَيْكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ إِنْ تَرَكَ خَيْرًا
الْوَصِيَّةَ لِلْوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِينَ بِالْمَعْرُوفِ حَقًّا عَلَى الْمُتَّقِينَ

“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (Vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejt. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer.”

(El-Bekare, 180)

Më vonë është shfuqizuar dispozita e obligueshmërisë, e ka mbetur dispozita e mustehabit për ata që nuk trashëgojnë prej të vdekurit, kurse ata që trashëgojnë, nuk kanë të drejtë në testament.

Ibn Omeri r.a. ka thënë: “Ajeti në fjalë është shfuqizuar me ajetet e trashëgimisë. Po ashtu edhe Muhamedi s.a.v.s., ka thënë: *“Vërtet Allahu ia ka dhënë të drejtën secilit (në trashëgimi), për këtë arsye nuk ka testament për trashëgimtarin.”* (Transmetojnë pesë koleksionistët, përpos Nesaiut).

Kur shpallet i pavlefshëm testamenti?

Testamenti shpallet i pavlefshëm në këto raste:

1. Nëse pasuria e lënë testament, shkatërrohet, humbet, prishet apo digjet, atëherë ai testament shpallet i pavlefshëm;
2. Nëse testamentpranuesi vdes para testamentlënësit, atëherë testamenti shpallet i pavlefshëm, ngase i vdekuri nuk mund as të pronësojë dhe as ta bëjë pranimin. Pas vdekjes ai testament kalon te trashëgimtarët;
3. Nëse testamentpranuesi e vret testamentlënësin;
4. Nëse testamentpranuesi e tradhton fenë;
5. Nëse testamentlënësi tërhiqet nga testamentlënia e tij. Një nga karakteristikat e testamentit është se testamentlënësi mund ta ndryshojë atë gjer në vdekje, dhe të hartojë testament të ri.

Për cilat çështje lihet testamenti?

Testamenti është mirë të lihet për çështjet në vijim:

1. Testamenti për nevojtarët prej të afërmeve, për jetimët dhe të varfrit;
2. Testamenti për ndërtimin e xhamive e shkollave në të cilat mësohet hifzi i Kur'anit, për ndërtimin e institucioneve, si Bashkësitë Islame;
3. Testamenti për botimin e librave;
4. Testamenti për studentët dhe luftëtarët në rrugë të Allahut;
5. Testamenti për dituri dhe për hulumtime shkencore;
6. Testamenti për ambulanca dhe spitale;
7. Testamenti për kryerjen e Haxhit apo umres për testamentlënës;
8. Testamenti për ujësjellës;
9. Testamenti për shlyerjen e borxheve të atyre që nuk kanë mundësi t'i paguajnë borxhet e tyre;
10. Testamenti për ndërtimin e jetimoreve.

Ekzekutuesi i testamentit

Ekzekutuesi i testamentit është personi të cilin trashëgimlënësi e përcakton në testament për t'u kujdesur që testamenti të realizohet në bazë të vullnetit të testamentlënësit.

Është mirë që testamentlënësi të autorizojë një person, i cili e merr përsipër ndarjen e tërë pasurisë së tij (ndarjen e trashëgimisë, larjen e borxheve etj.), pastaj, pas kryerjes së të gjitha obligimeve, bën edhe ekzekutimin e testamentit. Por, nëse testamentlënësi nuk e autorizon personalisht askënd, atëherë ekzekutimin e testamentit e bëjnë trashëgimtarët, e nëse nuk ka trashëgimtarë, atëherë këtë e merr përsipër Qeveritari Islam.

Nëse testamentit i ndryshohet destinimi apo nuk kryhet sipas porosisë, atëherë mëkati nuk bie mbi testamentlënësin, por mbi ekzekutuesin e testamentit. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

كُتِبَ عَلَيْكُمْ إِذَا حَضَرَ أَحَدَكُمُ الْمَوْتُ إِنْ تَرَكَ خَيْرًا
الْوَصِيَّةَ لِلْوَالِدَيْنِ وَالْأَقْرَبِينَ بِالْمَعْرُوفِ حَقًّا عَلَى الْمُتَّقِينَ

“Dhe kush e ndryshon atë (testamentin) pasi që ta ketë dëgjuar atë, atëherë pa kurrfarë dyshimi mëkati për të është për ata të cilët e kanë ndryshuar (destinimin e tij). Vërtet Allahu dëgjon dhe është i Ditur.” (El-Bekare, 181)

Vlefshmëria e testamentit

Testamenti fuqizohet menjëherë pas vdekjes së testamentlënësit, sepse, për sa kohë që të jetojë ende, ai ka të drejtë ta anulojë.

Për të qenë testamenti i vlefshëm, testamentlënësi duhet të mos jetë i ngarkuar me borxhe. Nëse është i ngarkuar me borxhe, të cilat kapin vlerën e tërë pasurisë që posedon, atëherë testamenti i tij është i pavlefshëm, e nëse borxhi i tij kap më shumë se dy të tretat e pasurisë së tij, atëherë vetëm një e treta e pasurisë së tij është e plotfuqishme për testament, e pjesa tjetër bëhet e pavlefshme. Mirëpo, nëse borxhlinjtë dhe trashëgimtarët ia falin edhe atë pjesë, atëherë fuqizohet testamenti.

Vetëm pas shlyerjes së borxhit, lind çështja e testamentit. Nëse testamenti e kalon shumën e borxhit, ai testament nuk plotësohet, veçse së pari shlyhet borxhi, e nëse pas larjes së borxhit mbetet diçka prej pasurisë, atëherë plotësohet ajo pjesë e testamentit. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

... مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِي بِهَا أَوْ دَيْنٍ ...

“(Kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet testamenti (vasijeti) që ka lënë dhe pasi të lahet borxhi...”,

(En-Nisa, 11)

Rendi e shpërndarjes së pasurisë së të vdekurit bëhet kështu:

- I paguhet borxhi (nëse ka);
- Ekzekutohet testamenti, dhe në fund,
- Pasuria e mbetur e të vdekurit trashëgohet nga trashëgimtarët.

Testamenti

Vëlla i nderuar, Islami nxit që të shkruash ose të lësh testament, sepse vdekja mund të të vijë befasisht. Duhet të jesh i kujdesshëm dhe i përgatitur, që gjithmonë të bësh vepra të mira, të jesh i sjellshëm, të shkruash testament ashtu që shpërblimet t'i kesh edhe pas vdekjes.

Ja një shembull si shkruhet një testament:

Testament:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Falënderimi i takon vetëm Allahut, përshëndetjet dhe begatitë qofshin për të Dërguarin e Allahut. Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka zot përveç Allahut, i Cili nuk ka ortak e as rival. Dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij. Dita e Kijametit do të ndodhë pa dyshim dhe Zoti do t'i ringjallë të vdekurit.

Ju lë testament, ashtu siç ka lënë testament Ibrahimí a.s. dhe Jakubí a.s.: "Vërtet, Allahu ka zgjedhur për ju këtë fe, dhe mos vdisni ndryshe, përveçse muslimanë." (El-Bekare, 132)

Ju lë vasijet (testament) të jeni të devotshëm, të falni namazin, të jepni zekatin, të agjëroni Ramazanin dhe të kryeni Haxhin, kur të kení mundësi.

Një të tretën e pasurisë sime e lë testament për çështjet në vijim:

- X euro (apo X parcelën,
X objektin) e lë për institucionet e Bashkësisë Islame apo për Xhami.
- X euro (apo X parcelën,
X objektin) për jetimë dhe për të varfrit.
- X euro (apo X parcelën,
X objektin) për ambulancë dhe për spital.
- X euro (apo X parcelën,
X objektin) për... etj. etj.
- Ju lë testament për X personin,
adresa, nr. i tel:;
- X euro për X personin, adresa,
nr. i tel:.
- Ju lë testament që ta kryeni haxhin (obligativ) për mua dhe umren;
- Ju lë testament që të ma kryeni kefaretin e ushqimit të 60 të varfërve, sepse e kam ngrënë dhe e kam prishur me qëllim një ditë të ramazanit.

Ju bëj me dije dhe dëshmoj para Zotit se çdo njeriu, i cili më ka bërë ndonjë të keqe, ia kam falur. Shpresoj që edhe ai, të cilit i kam bërë ndonjë të pahijshme, të më falë.

Në fund ju lë testament të gjithëve që për vdekjen time të bëheni të durueshëm dhe të pajtoheni me caktimin e Allahut të Lartmadhëruar.

Ky është testamenti im dhe "Kush e ndryshon pasi që e dëgjon, mëkati është mbi ata që e kanë ndryshuar. Vërtet Allahu dëgjon, është i Ditur." (El-Bekare, 181)

Testamentin e shkroi: _____,

Data: _____,

Adresa: _____.

Fusnotat:

1. Në teorinë juridike me termin “*Testament*” nënkuptohet urdhri i njëanshëm i vullnetit të fundit, me të cilin një person bën ndarjen e pasurisë së tij për rast vdekjeje, gjegjësisht, me të cilin një person bën rend tjetër trashëgimor nga ai i paraparë me ligj.

- Në traditën tonë, në vend të fjalës vasijet (testament), përdoret shprehja: “*E ka lënë me gojë*” ose “*E ka lënë me fjalë*”. Po ashtu përdoret edhe shprehja “*E ka lënë emanet*” ose “*E ka lënë emanetin e fundit të jetës*”. Fjala “*Emanet*” (*besueshmëri*) duhet të përdoret kur një njeri për së gjalli i lë në besim (emanet) një njeriu tjetër një send për sa kohë të mungojë ai. E, kur të kthehet, ajo që i është lënë në besë, i dorëzohet pronarit të tij, kurse Vasijeti nuk është i këtillë. Kjo do të thotë se në vend të fjalës “*Emanet*” duhet të përdoret fjala “*Vasijet*”.

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”.
21. “Texhvidi i muslimanit të vogël”.
22. “Moral i muslimanit të vogël”.
23. “Testamenti (Vasijeti)”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. *“Këshilltari fisnik për djem dhe vajza”* (nga autori Muhamed Sajim);
2. *“Islami dhe Politika”* (nga autori Jusuf Kardavi);
3. *“Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik”* (nga autori Abdurrezak Nufel);
4. *“Për Kushtetutën Islame”* (Dr. Muhamed Sejid Ahmed El-Musejer);
5. *“Kryesore në terminologjinë e Hadithit”* (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6. *“Vlera e kohës”* (nga autori Amër Halid);
7. *“Vëllazëria muslimane”* (nga autori Amër Halid);
8. *“Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë”* (nga autori Amër Halid);
9. *“Pendimi”* (nga autori Amër Halid);
10. *“Pasojat e mëkateve”* (nga autori Amër Halid);
11. *“Vendosmëria në rrugën e Allahut* (nga Amër Halid);
12. *“Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut* (nga Amër Halid);
13. *“Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë”* (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir).
14. *“101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë”* (nga autori Muhamed Eminë Xhundi).
15. *“Fetavatë e Shaëravijut”*.

PËRMBAJTA:

Hyrja	3
Testamenti (vasijeti)	6
Argumentet e ligjësimit të testamentit	7
1. Argumenti nga Kur'ani	7
2. Argumenti i Sunetit	8
3. Argumenti i Ixhamit	8
4. Argumenti logjik	8
Urtësia e testamentit	9
Ruknet e testamentit	10
Kushtet e testamentit	11
- Kushtet e testamentlënësit	12
- Kushtet e sendit të lënë testament	13
- Kushtet e testamentpranuesit (legatorit)	14
Llojet e testamentit	15
1. Testamenti vaxhib (i obliguar)	15
2. Testamenti haram (i ndaluar)	16
3. Testamenti mekruh (i urryer)	17
4. Testamenti mubah (i lejuar)	18
Kur shpallet i pavlefshëm testamenti?	20
Për cilat çështje lihet testamenti?	21
Ekzekutuesi i testamentit	22
Vlefshmëria e testamentit	23
Testamenti	24
Librat e autorit (Dr. Musli Vërbanit)	28
Përkthimet nga gjuha arabe	29

Donatorë:

Haxhi Refet Neziri

Haxhi Fikri Jusufi

Haxhi Mustafë Ajruli

Autori falënderon donatorët dhe e lut Allahun t'i shpërblejë
me Xhenet.